



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2024:020037
Datë: 21.03.2024
Numri i dokumentit: 05485773

P.nr. 17/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË- Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Lulzim Paçarizi, si dhe bashkëpunëtoren profesionale Hajrije Krasniqi, në çështjen penale ndaj të akuzuarit L. J., për shkak të veprës penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës PP/II.nr.38/24 të dt. 17.01.2024, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar, të dt.19.03.2024, ku prezent ishin Prokurori i shtetit Anton Hasanaj, i dëmtuari E. Z. me përfaqësuesin e tij ligjor-prindin A. Z., si dhe i akuzuari L. J. me dt.21.03.2024 shpallë dhe e përpilon këtë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI: L. J. nga i ati A.dhe e ëma M.e lindjes H., i lindur me dt...., në fshatin S., Komuna e Malishevës, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i R. të Kosovës, i martuar, i ati i 4 (katër) fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor në sektorin privat, i gjendjes së dobët ekonomike.

Ë S H T Ë F A J T O R

Për shkak se me datë 23.12.2023 në fshatin S., Komuna e Malishevës, i pandehuri nga pakujdesia shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve, në atë mënyrë që në ditën kritike nuk e siguron kafshën shtëpiake-qenin e tij (nuk e mban të lidhur) edhe pse i vetëdijshëm se një veprim i tillë mund të shkaktoj pasoja konkretisht kafshimin e ndonjë personi, por me mendjelehtësi mendon se nuk do ta kafshojë askënd, ashtu që derisa i mituri E. Z. ishte duke shkuar në market për të blerë gjësende, i vërsulet qeni dhe pasi që i mituri rrëzohet duke ikur qeni i vërsulet përmbi, por që për fat të mirë aty kalon një kalimtar rasti dhe arrin që ta shpëtojë, me çka tek i mituri është shkakuar frikë për jetën dhe shëndetin e tij.

- me këto veprime ka kryer veprën penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.6 lidhur me pra.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform nenit 4,7,17, 38, 39, 40, 43 dhe 69 të KPRK-së (Kodit nr. 06/L-074) si dhe nenit 365, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të njëjtit ia shqipton:

DËNIMIN ME GJOBË

1 (5)

Ashtu që e gjykon me dënim me gjobë në lartësi prej 600 € (gjashtëqind) euro, , të cilën shumë i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në xhirollogarinë e kësaj gjykate në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi i shqiptuar me gjobë do të zëvendësohet me dënim burgu, në kohëzgjatje prej 30 ditësh, duke llogaritur çdo ditë burgu nga 20 euro.

I dëmtuari E. Z. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin civil.

Obligohet i akuzuarit në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t`ia paguajnë shumën prej 30 euro, ndërsa 20 € për programin për kompensimin e viktimave të krimit, ndërsa shpenzime të procedurës penale nuk ka pasur, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ekzekutimi do të bëhet me detyrim.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.38/2024 të dt. 17.01.2024, e ka akuzuar L. J., për shkak të veprës penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor si dhe administrimit të provave, të akuzuarin t`a shpall fajtor dhe t`a dënoj në bazë të ligjit.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 19.03.2024, ku prezent kanë qenë përfaqësuesi i akuzës, prokurori i shtetit Anton Hasanaj, i dëmtuari E.Z. me përfaqësuesin e tij ligjor-prindin A. Z., si dhe i akuzuari L. J., andaj ka pasur kushte për mbajtjen e shqyrtimit fillestar.

I akuzuari L. J., në shqyrtimin fillestar është deklaruar i fajshëm për veprën penale për të cilën ngarkohet, duke shtuar se me vjen keq për rastin i cili ka ndodhur për të cilin jam penduar, ky ka qenë rasti im i parë që kam ra ndesh me ligjin, andaj kërkoj nga gjykata që të merren parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese me rastin e shqyrtimit të dënimit dhe të më shqiptoj një dënim sa më të butë, ku i premtoj gjykatës që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm që mos të kryej kurrfarë vepre penale.

Përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarit të mitur E. Z., prindi A. Z. deklaron: nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë së të akuzuarit, sa i përket ndjekjes penale ia lë në vlerësim gjykatës, ndërsa parashtron kërkesë pasurore juridike.

Prokurori i shtetit Anton Hasanaj në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari pasi që ky pranim i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion duke i ditur pasojat dhe benifitet e një

pranim i tillë, si rrethanë lehtësuese me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit propozoj gjykatës që të ketë parasysh pranimin e fajësisë, pendimin për veprën penale të kryer, kërkim faljen, ndërsa si rrethana rënduese gjykata duhet ti ketë parasysh faktin se i dëmtuari është viktimë e ndjeshme si dhe të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 242 të KPPRK-së. Gjatë pranimi të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoj se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

- se i akuzuari L. J. nga pakujdesia ka kryer veprën penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjendjen e këtillë faktike e mori në tërësi ashtu siç ishte përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë:

- Raporti fillestar i incidentit, me nr. ... i datës 23.12.2023;
- Raporti i oficerit E. K., CP# ..., me nr. ... i dt. 16.01.2023;
- Raporti i oficerit A. K., ID# ..., me nr. ... i dt. 17.01.2023;
- Raporti i oficerit B. M., ID# ..., me nr. ... i dt. 23.02.2023;
- Raporti i oficerit K. K., CP# ..., me nr. i dt. 25.05.2023;
- Raporti i oficerit S. K., PK# ..., me nr. i dt. 23.02.2023;
- Vendimi për kundërvajtje lëshuar nga Policia e Kosovës me nr.... i datës 15.11.2023;
- Deklarata e përfaqësuesit ligjor (prindit) të dëmtuarit, A. Z. dhënë në polici me datë 23.12.2023;
- Deklarata e të pandehurit L. J. dhënë në polici me datë 23.12.2023;
- Fotografitë si dhe shkresat tjera në lëndë.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 356 par.6 lidhur me par.1 është paraparë se (par.6) „Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet”, ndërsa në (par.1) “Kushdo që me anë të zjarrit, vërshimeve, armëve,

eksplozivit apo ndonjë mjeti tjetër vdekjeprurës, helmit ose gazit helmues, rrezatimit jonizues, forcës mekanike, me energji elektrike ose me ndonjë lloj energjie tjetër, ose me ndonjë veprim tjetër të rrezikshëm apo mjete të rrezikshme, shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve apo dëm të konsiderueshëm pasuror, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet”.

5. Vendimi i gjyqtarit të vetëm gjykues.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin L. J. e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet, nga se në veprimet e tij të përshkruara si në dispozitivin e aktgjykimit, formohen të gjitha elementet e veprës penale shkaktim i rreziku të përgjithshëm nga neni 356 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykoj në bazë të ligjit, e me parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit ka vlerësuar që të pandehurit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij, gjykata me rastin e matjes së dënimit pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-së ashtu që gjykata me rastin e caktimit të dënimit pati parasysh rrethanat lehtësuese si pranimin e fajit nga ana e të pandehurit, i njëjti është penduar dhe i ka kërkuar falje të dëmtuarit, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla, është mbajtës i familjes prej 6 anëtarësh, për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, nuk është recidivist, ndërsa si rrethanë rënduese për të akuzuarin gjykata mori parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, i dëmtuari është viktimë e ndjeshme, dhe për këtë gjykata të pandehurit i shqiptoj dënimin me gjobë në lartësi prej 600 € (gjashtëqind) euro si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjithnjë duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit mund të arrihen qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi mbi udhëzimin në kontestin civil

I dëmtuari E. Z. konform nenit 457 KPPK-së është udhëzuar në kontestin civil, pasi që e njëjta ka parashtruar kërkesë pasurore juridike ndaj të akuzuarit.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penal

Vendimi paushallin gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Ndërsa vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 39 parg. 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit nr.05/L036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Me sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr. 17/24, me dt. 21.03.2024.

Bashkëpunëtorja profesionale
Hajrije Krasniqi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Lulzim Paçarizi

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.